



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Tiranë, më 25.2.2019

Lënda: Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik Darjel Sina, në seancën publike të datës 25.2.2019, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Antoneta Sevdari

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të trupit gjykues!

Në çështjen objekt shqyrtimi, nisur nga gjendja e akteve dhe vlerës provuese të tyre, të cilat Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i ka konsideruar të mjaftueshme që me vendimin nr. 42, datë 18.7.2018, të konfirmojë në detyrë subjektin e rivlerësimit znj. Antoneta Sevdari, Komisioneri Publik nuk ndan të njëjtin qëndrim, e në këto kushte, bazuar në nenin C, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, vuri në lëvizje juridiksionin rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke adresuar disa çështje dhe kërkime me qëllim kontrollin e këtij vendimi të Komisionit. Konkretisht, rivlerësimin e kriterit të pasurisë dhe atij profesional për subjektin e rivlerësimit.

Kështu, Komisioneri Publik kërkoi nga ana e kësaj Trupe të Nderuar të vlerësojë për:

I. Ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer si burim për krijimin e 1/3 së pasurisë tokë-arë dhe shtëpi banimi, lidhur me:

- a. të ardhurat e deklaruara të përfituara nga emigracioni në Greqi i personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit gjatë viteve 1997-2000, si dhe
- b. të ardhurat prej 12.000 euro, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, të përfituara nga puna e personit të lidhur/bashkëshortit në Mbretërinë e Arabisë Saudite, në vitin 2003¹.

Nëse për këto të ardhura aktet e administruara provojnë ligjshmërinë e tyre, në referencë

¹ Këto të ardhura nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit as në deklaratën e pasurisë “Vetting” dhe në DV (Deklarata Vjetore) për vitin 2003 apo 2004, por janë deklaruar vetëm gjatë procesit të rivlerësimit pranë KPP-së.

të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe udhëzimit nr. 4095 prot. datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së².

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi asnjë provë për të kundërtën e këtij shkakut të ankimit.

Vlen të theksohet gjithashtu se nga analiza financiare, e kryer nga Komisioneri Publik, konstatohet se për periudhën 2000-2003, në të cilën subjekti deklaroi se ka qarkulluar 3.000.000 lekë, për krijimin e 1/3 të pasurisë dhe 3.000 - 4.000 euro për mobilimin e saj, të ardhurat e ligjshme nuk janë të mjaftueshme për justifikimin e këtyre shpenzimeve. Të ardhurat e ligjshme në këtë periudhë rezultojnë në shumën 1.869.447 lekë.

II. Lidhur me të ardhurat nga puna e personit të lidhur në Mbretërinë e Arabisë Saudite në shumën 18.970 USD, deklaruar në deklaratën vjetore për vitin 2006

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, nga shqyrtimi gjyqësor, u provua se, ndryshe nga sa pretendoi subjekti i rivlerësimit, bazuar në legjislacionin tatimor (shqiptar) në fuqi, në vitin 2006, këto të ardhura duhet të ishin deklaruar dhe për to duhet të ishin paguar detyrimet fiskale, me qëllim që në zbatim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, ato të konsiderohen si të ardhura të ligjshme.

Edhe në këtë rast, subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi asnjë provë për të kundërtën e këtij shkakut të ankimit.

Për sa më sipër, sikurse dhe për shkaqet e ankimit lidhur me të ardhurat nga aktiviteti privat i personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për vitin 2010 dhe 2016, si dhe shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e aftësive profesionale, Trupi gjykues refuzoi kërkesën e Komisionerit Publik për riçeljen e hetimit administrativ, pasi konsideroi se dokumentacioni i administruar është i mjaftueshëm për zgjidhjen e kësaj çështjeje, duke i dhënë fund shqyrtimit gjyqësor.

➤ Në këto kushte, referuar nenit F, të aneksit të Kushtetutës, në konsideratë të shkaqeve të ngritura në ankim dhe sa kemi parashtruar gjatë shqyrtimit

² “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””.

gjyqësor të kësaj çështjeje, përfundimisht Komisioneri Publik, bazuar në pikat 3 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelit:

- Ndryshimin e vendimit nr. 42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit³.

Darjel SINA
Komisioner Publik

³ Ky është kërkimi përfundimtar i Komisionerit Publik gjatë seancës gjyqësore në KPA, datë 25.2.2019.